



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

PËR KONKURRUESHMËRINË DHE RRITJEN E AKSESIT NË TREGJE TË PRODUKTEVE SHQIPTARE JO-USHQIMORE ME STANDARDE EVROPIANE

- Perceptime të biznesit

Tiranë, Korrik 2024

LISTA E SHKURTIMEVE

Ky dokument pune është përgatitur në kuadër të Mbledhjes XXXIV të Këshillit të Investimeve (3 shtator 2024) nga ekspertët e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve, znj. Elida Fara, Eksperte Ekonomike, z. Elvis Zerva, Ekspert Ligjor dhe Rregullator, znj. Xaira Shurdha, Eksperte Monitorimi dhe Ndërlidhjes, si dhe me kontributin e ekspertes së jashtme, znj. Anila Jani, nën drejtimin e Drejtores së Sekretariatit, Dr. Diana Leka (Angoni). Mbështeti në redaktimin gjuhësor të materialit, znj. Elisa Lula, Oficere Administrative dhe Komunikimit në Sekretariat.

Falenderojmë për bashkëpunimin në procesin e konsultimit, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), Inspektoratin Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut (ISHMT), Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit (DPA), Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Shoqatën e Biznesit Grek në Shqipëri (HBAA), Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Durrës, Shoqatën Shqiptare të Ndërtuesve (SHNSH), Shoqatë "Pro Export Albania", Shoqatën Shqiptare të Tregtisë Elektronike (AECA), Institutin e Ndërtimit, Albamachinery shpk, Emante Panel shpk, PSZ GMBH, Delta Group si dhe 143 kompanitë që u përgjigjën anketës, për bashkëpunimin e tyre të çmuar në përgatitjen e këtij materiali.

ALL	Lek Shqiptar
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BIDS	Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve
BP	Ballkani Perëndimor
CAB	Trupat e Çertifikimit të Konformitetit
CE	Konformiteti European
DPA	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPS	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
ERP	Programi i Reformave Ekonomike
GDP	Prodhimi i Përgjithshëm Bruto
ISHMT	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
ISHTI	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial
KI	Këshilli i Investimeve
KM	Këshilli i Ministrave
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
NVM	Ndërmarrje e Vogël dhe e Mesme
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
RS	Reforma Strukturore
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
METODOLOGJIA	7
KONTEKSTI	8
KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONALL	13
GJETJE KRYESORE NGA ANKETIMI	18
GJETJE KRYESORE DHE ANALIZA	20
REKOMANDIME	34
BIBLIOGRAFIA	37
SHTOJCA I - PYETËSORI I ANKETËS SË BIZNESIT	39
SHTOJCA II - PYETËSOR SPECIFIK PËR MAKINERIA/ PAJISJET ELEKTRIKE	41
SHTOJCA III - PYETËSOR SPECIFIK PËR PRODUKTET NDËRTIMORE	42
SHTOJCA IV - INDEKSI I POLITIKAVE TË NVM-VE, BALLKANI LINDOR DHE TURQIA 2022	44

HYRJE

Një nga faktorët kryesorë të përmirësimit të ndërkombëtarizimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) është aftësia e kompanive vendase për të demonstruar cilësinë dhe sigurinë e mallrave dhe shërbimeve, si dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare. Më 2 shkurt 2022, Bashkimi Evropian (BE)¹ prezantoi një strategji të re standardizimi² dhe rregullime përkatëse³ legjislative në rregulloren e standardizimit, duke vendosur një vizion të ri mbi standardet globale në mbështetje të një tregu të vetëm elastik, të gjelbër, digjital të BE-së dhe duke përcaktuar detyrat për shtetet anëtare të BE-së dhe ato kandidatë.

Duke iu referuar proceseve të fundit të integritimit BE-Shqipëri (Plani i Rritjes dhe dinamika

rajonale), ndër prioritetet e rena dakord në nivel politik, janë infrastruktura cilësore, zinxhiri i furnizimit, programi i eksporteve me BE-në (udhërrëfyesi në shtyllën 3 dhe 4). Në këtë kontekst, prioritetizimi i përafrimit të angazhimit politik të qeverisë me aspiratat e biznesit vendas dhe përpjekjet për të përmbushur standardet ndërkombëtare janë thelbësore. Por nga perspektiva e zinxhirit të furnizimit, pajtueshmëria me kërkesat e reja për qëndrueshmëri, ekonomi të gjelbër dhe digjitale, paraqet sfida të reja. Për të konkurruar me sukses, sipërmarrësit kanë nevojë paraprakisht *për më shumë njohuri mbi mundësitë e reja të tregut të BE-së, por edhe se si të kontrollojnë faktorët e jashtëm të zinxhirit të furnizimit duke vazhduar të përfitojnë nga tregu vendas*. Këto njohuri do të ndihmonin për të marrë në konsideratë zinxhirë alternativë të furnizimit/opsionet e reja të tregut duke minimizuar rrezikun dhe duke kontrolluar kostot.

Që nga marsi 2024, përputhja me standardet ndërkombëtare është votuar si një prioritet kryesor nga anëtarët e biznesit të Këshillit të Investimeve. Kjo çështje ka qenë më parë një shqetësim për sipërmarrësit vendas, por i

1 COM (2022) 31- https://single-market-economy.ec.europa.eu/single-market/european-standards/standardisation-policy/standardisation-strategy_en

2 Deklarata e Komisionit Evropian- "Përditësimi i Strategjisë së Re Industriale 2020: Ndërtimi i një tregu më të fortë të përbashkët për rimëkëmbjen e Evropës"- https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_21_1884

3 Për shembull: <https://www.eurofins.com/textile-leather/articles/eu-regulation-2019-1020-impact-e-commerce/>

parë nga këndvështrime të ndryshme, të tilla si integrimi në zinxhirët globalë të vlerës (2021), kalimi në burimet alternative të energjisë (2023) dhe adresimi i administrimit të taksave, inovacionit dhe produktivitetit (në fillim të 2024). Anketa e fundit e Sekretariatit të KI me 601 kompani tregoi se 77% e tyre planifikonin të investonin në produktivitet për të konkurruar në tregje të reja si BE-ja.

Për të vendosur kontekstin, se si të përmirësohet aksesimi në treg i kompanive vendase përmes një përputhshmërie më të mirë me standardet globale, Sekretariati ndërveproi me partnerë vendas të sektorit privat (143 kompani, ku nga 25% eksportues, 55% eksportojnë në tregjet e BE-së) dhe realizoi konsultime me synimin për të kuptuar perceptimin e tyre në lidhje me katër shtylla a) ndërgjegjësimi i sipërmarrësve për kërkesat e legjislacionit të përgjithshëm dhe specifik për respektimin e standardeve/rregulloreve teknike/mbikëqyrjes së tregut, b) aksesimi në informacion, c) mbështetja institucionale

nëse duan të jenë në përputhje me standardet, d) kapacitetet aktuale vendore të zbatimit/inspektimeve. Për të pasur një perspektivë më të qartë, Sekretariati kreu një analizë paraprake të të dhënave të eksporteve për të identifikuar *mallrat joushqimore* më të eksportuara gjatë dhjetë viteve të fundit dhe ato me rritjen më të lartë të eksporteve. Nga kjo analizë, Sekretariati evidentoi sektorë kyç, të cilët më pas u vendosën në fokus të takimeve konsultative me biznese specifike në industrinë përpunuese dhe të ndërtimit.

Në mungesë të një strategjie eksporti, ky dokument mund të shërbejë si një hap përgatitor për krijimin e një liste prioritare të produkteve vendore dhe sektorëve me avantazh konkurrues në eksport. Kjo është thelbësore për ndërtimin e infrastrukturës së cilësisë së produktit nga perspektiva e zinxhirit të vlerës. Strategjikisht, përpjekjet aktuale synojnë gjithashtu të stimulojnë dialogun se si Shqipëria të bëhet një vend eksportues neto me industri lokale me vlerë të lartë të shtuar pjesë në zinxhirët globalë të vlerës deri në vitin 2030.

METODOLOGJIA

Analiza mbështetet në një metodologji të gjerë që përfshin:

HULUMTIM NDËRSEKTORIAL

- Konsultim i dokumenteve*, ligjeve dhe akteve nënligjore, praktikave institucionale dhe kuadrit institucional përgjegjës për infrastrukturën cilësore dhe tregtinë dhe fazat e harmonizimit të legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së në lidhje me industritë joushqimore.
- Sintezë* e gjetjeve dhe rekomandimeve të paraqitura në raportet kombëtare dhe ndërkombëtare nga aktorë të ndryshëm për temën e analizuar.
- Përpilim i komenteve nga komuniteti i biznesit*, duke përfshirë dhomat e tregtisë, shoqatat e industrisë, dhe raportet apo indekset e dokumentuara, si kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare. Gjithashtu, Sekretariati në përgatitjen e analizës ka marrë në konsideratë diskutimet, ankesat dhe çështjet e ngritura nga komuniteti i biznesit gjatë takimeve të Sekretariatit dhe KI-së, si dhe të dhënat nga databaza e brendshme e Sekretariatit “Mbi Klimën e Investimeve dhe Çështjet e Biznesit” (2015-2023).
- Punë paraprake* për të identifikuar produktet më të eksportuara gjatë dhjetë viteve të fundit dhe ato me rritjen më të lartë të eksporteve. Në bazë të kësaj analize u identifikuan aktivitetet ekonomike për një analizë më të fokusuar.

HULUMTIM I DREJTPËRDREJTË

Kërkim cilësor

- Modeli i intervistës gjysmë të strukturuar* për takime të drejtpërdrejta me 6 institucionet qendrore përgjegjëse për infrastrukturën e cilësisë dhe tregtisë si Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), Drejtoria e Përgjithshme i Akreditimit (DPA), Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrja e Tregut (ISHMT), etj.
- interviste gjysmë të strukturuar* për takime të drejtpërdrejta 8 me komunitetin e biznesit të angazhuar në sektorë/produkte të identifikuar, kryesisht produkte industriale si ndërtimi, prodhimi elektrik, etj.

KËRKIM SASIOR

- Një anketim i strukturuar* u krye online me sektorin privat nga muaji maj deri në qershor 2024. Anketa kishte për qëllim të identifikonte perceptimet dhe sfidat kryesore me të cilat haset sektori privat brenda fushave: (i) *Ndërgjegjësimi ndaj kërkesave ligjore për produktet jo-industriale*; (ii) *Qasja në informacion*; (iii) *Mbështetja institucionale*; dhe (iv) *Sfidat ndaj standardeve*. U përfatuan 143 përgjigje në mënyrë anonime. Të anketuarit përfaqësojnë ndërmarrje në sektorë të ndryshëm të ekonomisë⁴, duke përfshirë të gjitha rajonet e vendit.

⁴ Kompanive iu kërkua të identifikoheshin sipas aktivitetit kryesor që përfaqësonte pjesën më të madhe të xhiros së tyre.

KONTEKSTI

Në këtë seksion përfshihen vetëm dokumentet kryesore strategjike publike që ofrojnë masa të drejt-përdrejta dhe veprime konkrete në lidhje me infrastrukturën e cilësisë dhe konkurrueshmërinë. Përveç kësaj, ekzistojnë disa strategji me ndërsektoriale me shtyllat e mësipërme, si Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (BIDS) 2021-2027 ose dokumente në kuadër të bashkëpunimit rajonal që mbulojnë (integrimin tregtar, përpjekjet rajonale, harmonizimin dhe zbatimin e *acquis* të BE-së, çfarë duhet të presin bizneset kur të hyjnë në tregun e BE-së, etj.).

3.1 VIZIONI POLITIK

3.1.1 BIDS⁵ 2021-2027

Strategjia aktuale ka natyrë horizontale, e cila

5 Strategjia për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 466, datë 30.07.2021. Strategjia zbatohet në periudhën 2021-2027, ndërsa roli drejtues në zbatimin e saj i takon tashmë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit si institucioni përgjegjës për fushën e biznesit dhe investimeve. Përgjegjësia për zbatimin e secilës masë përcaktohet nga plani i veprimit dhe ndahet ndërmjet disa ministrave, institucioneve në varësi, pushtetit vendor dhe aktorëve të tjerë.

nuk është e fokusuar në mbështetjen e industrive apo ndërmarrjeve të veçanta. Ajo përbën një udhëzues për kompanitë që dëshirojnë të zhvillojnë dhe përmirësojnë aftësitë e tyre konkurruese, të zhvillojnë produkte dhe shërbime inovative, duke inkurajuar një rritje të qëndrueshme afatgjatë. *Një nga objektivat kryesore të strategjisë fokusohet në zhvillimin e sektorit industrial. Rritja e aftësisë së vendit për përpunimin e lëndëve të para në shtëpi dhe rritjen e vlerës së shtuar nëpërmjet nxitjes së investimeve, aplikimit të teknologjive të reja, prodhimit të pastër dhe rritjes së profesionalizmit që përbëjnë themelin e krijimit të një industrie konkurruese.* Sikurse vërejtur më parë nga KI, kompanitë shqiptare përballen me disa kufizime dhe sfida në rritjen e eksporteve dhe depërtimin në tregjet e huaja, rajonale dhe të BE-së. Disa prej tyre përmenden edhe në strategji:

- » Një sfidë e madhe për zhvillimin e eksportit është përputhja me standardet ndërkombëtare të cilësisë, shëndetit dhe sigurisë.
- » Infrastruktura e dobët rrit ndjeshëm koston e prodhimit dhe është një pengesë e konsiderueshme për eksport.

- » Një sistem i dobët financiar është një pengesë kryesore për nxitjen e zhvillimit të eksporteve, sepse mund të rrisë kostot e transaksionit. Në veçanti, kufizimet e aksesit në kredi paraqesin një pengesë të rëndësishme në eksporte, veçanërisht kur mundësitë nga buxheti për sigurimin e granteve janë të kufizuara.
- » Cilësia e ulët e produkteve dhe e shërbimit që u ofrohet atyre.
- » Aftësi të kufizuara menaxheriale për të pozicionuar produktet “Made in Albania” në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare.
- » Mungesa e njohurive për marketingun e produkteve, duke shkaktuar vështirësi për hyrjen e produkteve të reja në treg për eksport.
- » Niveli i lartë i informalitetit.
- » Kosto të larta transporti për eksportin e produkteve shqiptare. Ky shqetësim bëhet veçanërisht i ndjeshëm për tregjet më të largëta (më shumë se 1000 km) nga Shqipëria.

Strategjia ka tre objektiva specifike: (a) tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi; (b) zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni dhe (c) zhvillimi i kapitalit njerëzor. *Në lidhje me objektivin e parë, që është edhe objekt i kësaj Note Teknike, janë parashikuar disa masa konkrete, ndër të cilat ishte dhe përgatitja dhe miratimi i strategjisë së eksportit brenda vitit 2022.*

3.1.2 ERP 2024 – 20266

Programi i Reformave Ekonomike (ERP) përmbledh masat dhe reformat prioritare të qeverisë së Shqipërisë në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme me synim rritjen e prodhimit vendas, nxitjen e investimeve të reja dhe sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm

dhe rritjen e konkurrueshmërisë. Për këtë qëllim, ai nënvizon nevojën për përgatitjen e programit të nxitjes së gatishmërisë për eksport sipas “Politikave të Eksportit Shqiptar 2023-2027”. Në ERP nënvizohet se Ministria e Financës dhe Ekonomisë (MFE)⁷ po punon për hartimin e Programit të Eksportit 2024-2027 në bashkëpunim dhe konsultim të ngushtë me palët e interesuara private dhe publike. Puna për programin e eksportit duhet të vazhdojë dhe të vijojë konsultimet për t’u pasuruar me rekomandime deri në finalizim.

Nga verifikimet e Sekretariatit dhe takimet me institucionet, u konfirmua se Strategjia/Programi për Eksportet ende nuk është finalizuar dhe as aprovuar. Ishte e vështirë të identifikoheshin produktet industriale (jo ushqimore) me të cilat bizneset shqiptare kanë një avantazh konkurrues në tregjet rajonale dhe ato të BE-së. Identifikimi i produkteve të tilla mund të jetë më tej objekt i një analize shtruese të detajuar së bashku me çështjet përkatëse të certifikimit, barrierat tarifore dhe jotarifore. Përveç sa më sipër, Sekretariati evidentoj gjithashtu se Shqipërisë i mungon ende një politikë industriale. Disa elementë që lidhen me zhvillimin dhe sfidat e industrisë (tranzicioni i gjelbër, ndryshimet klimatike, pengesat e prodhimit dhe konkurrenca, digjitalizimi, etj.) janë shpërndarë në një formë të përgjithshme në dokumente dhe strategji të ndryshme (PKIE, ERP, etj.), por ende të pa integruara në një dokument të konsoliduar.

6 Miratuar me VKM nr. 12 datë 11.01.2024

7 Tani MEKI dhe MF

3.1.3 Plani i Rritjes

Gjatë majit 2024, liderët e Ballkanit Perëndimor (BP) dhe përfaqësuesit e BE-së dhe SHBA-së u takuan në Samitin e Kotorrit për të diskutuar mbi Planin e Rritjes për Ballkanin Perëndimor dhe vazhdimin e rrugës së BE-së të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Samiti u organizua nën sloganin “Një rajon, një vizion i përbashkët”. Gjatë Samitit u riafirmua se *Tregu i Përbashkët Rajonal (TPR) është instrumenti kyç për të nxitur integrimin ekonomik brenda Ballkanit Perëndimor, bazuar në rregullat dhe standardet e BE-së*. Kjo fazë e re e TPR, vepron si një gur hapi drejt tregut të vetëm të BE-së në shumë sektorë, duke zhbllokuar potencialin ekonomik të rajonit, duke krijuar mundësi për sektorin tonë privat dhe NVM-të si dhe për punëtorët, duke e bërë rajonin tonë një vend tërheqës për investitorët evropianë dhe si një mekanizëm për të bërë përparim në negociatat e anëtarësimit duke korrur përfitime të hershme ekonomike. Krahas angazhimeve të mësipërme, masa konkrete për fushat e reja për veprim u prezantuan nga Komisioni i BE-së, njëra prej të cilave lidhet me Marrëveshjet Dypalëshe për Vlerësimin dhe Pranimin e Konformitetit (ACAA) për produkte specifike, duke u fokusuar si hap i parë në produktet elektrike, produktet elektromagnetike dhe sektori i makinerive. Ndërsa dokumenti detajon kuadrin ligjor që duhet miratuar dhe përmirësuar, ai u bën thirrje vendeve të BP të forcojnë kapacitetet administrative dhe të infrastrukturës cilësore në nivelin e kërkuar.

3.2 VLERËSIME NGA RAPORTET NDËRKOMBËTARE

3.2.1 Progres Raporti 2023 i BE për Shqipërinë

Raporti vlerëson se Shqipëria ndodhet mes një niveli të moderuar përgatitjeje në lidhje me lëvizjen e lirë të mallrave. *Përsa i përket infrastrukturës së cilësisë, disa baza ligjore ende*

nuk janë përafruar dhe, megjithëse ka nisur procesin, Shqipëria ende nuk është anëtarësuar plotësisht në të gjitha organet e standardeve të BE-së. Rekomandimet e mëparshme mbeten ende të vlefshme, pasi nevojiten ende përpjekje për të siguruar harmonizimin legjislativ dhe për të forcuar zbatimin. Fokusi i rekomanduar i ndërhyrjeve duhet të jetë:

- » Të përfundojë përafrimin e legjislacionit të tij me *acquis* e BE-së në lidhje me infrastrukturën e cilësisë, p.sh. për akreditimin, vlerësimin e konformitetit dhe mbikëqyrjen e tregut.
- » Të forcojë ndjeshëm kapacitetin zbatues të inspektoratit të mbikëqyrjes së tregut.
- » Të miratojë një plan veprimi për shqyrtimin e të gjithë legjislacionit vendas, procedurave dhe praktikave administrative në përputhje me nenet 34-36 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), i cili mbulon plotësisht fushën e pabarmonizuar, me një afat kohor për shqyrtimin e të gjithë legjislacionit dhe praktikave të tilla dhe për futjen e klauzolave të njohjes reciproke ose shfuqizimin dhe/ose ndryshimin e legjislacionit dhe praktikave sipas nevojës.

Ndërsa në mënyrë specifike për fushën e harmonizuar dhe infrastrukturën e cilësisë, raporti pranon se megjithëse tashmë ekzistojnë struktura administrative për t'u marrë me rregulloret teknike, standardizimin, vlerësimin e konformitetit, metrologjinë, akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut, **duhet të plotësohet edhe rekrutimi i stafit të kualifikuar për të siguruar mbikëqyrjen e tregut të të gjithë sektorëve të harmonizuar**.⁸

⁸ Shqipëria ka marrëveshje të ndërsjella bashkëpunimi për akreditimin, standardizimin dhe vlerësimin e konformitetit me disa shtete anëtare të BE-së, vende të tjera të rajonit dhe vende të tjera jashtë BE-së.

3.2.2 OECD

3.2.1 Indeksi i Politikave të NVM-ve Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2022⁹ është një raport periodik që bën një pasqyrë të zbatimit të Aktit të Biznesit të Vogël për Evropën gjatë periudhës 2019-2022 dhe një skanim sistematik të sfidave dhe mundësive për SME-të në disa dimensione. Sipas raportit, Shqipëria ka:

- » Arritur vlerësimet mesatare më të larta në fushat e mëposhtme: kuadri institucional dhe rregullator për politikëbërjen e NVM-ve.
- » *Mjedisi operacional për NVM-të; prokurimin publik; standardet dhe rregulloret teknike; dhe ndërkombëtarizimin e NVM-ve, ku gjithashtu tejkalon mesataren e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë (BPT). Për më tepër, ai pranon se përafrimi dhe mbështetja e zbatimit e BE-së për NVM-të në rregulloret dhe standardet teknike u zgjerua*. Shqipëria vazhdoi të harmonizojë infrastrukturën e saj të cilësisë me *acquis* të BE-së në fusha kyçe si metrologjia dhe po zhvillon një udhërrëfyes për të identifikuar rregulloret teknike të pabarmonizuara të mbetura. Në të njëjtën kohë, Shqipëria forcoi gjithashtu kapacitetet e stafit të institucioneve të saj të infrastrukturës cilësore dhe zgjeroi një programmbështetës për NVM-të që kërkojnë certifikim sipas standardeve evropiane ose ndërkombëtare. Në përgjithësi, këto aktivitete do të përmirësojnë aksesin për NVM-të që duhet të certifikojnë produktet, shërbimet ose proceset e tyre në përputhje me standardet dhe rregulloret evropiane. Një përmbledhje e dimensionit 7 është e detajuar nën Shtojcën IV.

Perspektiva e Konkurrueshmërisë së Ball-

kanit Perëndimor 2024: Shqipëria¹⁰ diagnostikon se Shqipëria ka bërë përparime të rëndësishme që nga viti 2021 *Konkurrueshmëria në Evropën Juglindore: Një Perspektivë Politike (Perspektiva e Konkurrueshmërisë)*, duke përparuar pozitivisht në 14 nga 15 dimensionet e politikave dhe duke ngecur në një ndërmarrje shtetërore (NSH). Shqipëria përjetoi rritjet më të forta të rezultateve në fushat e politikave anti-korrupsion, bujqësisë dhe punësimit. *Për më tepër, raporti thekson se Shqipëria po e kalon mesataren e gjashtë ekonomive të Ballkanit Perëndimor (BB6) në 13 dimensionet e politikave*. Për më tepër, ajo është lider rajonal në disa fusha, duke arritur rezultatin më të lartë në politikat antikorrupsion, arsim dhe punësim. Në të kundërt, Shqipëria ka pikë nën mesataren rajonale si në NSH, ashtu edhe në shkencë, teknologji dhe inovacion (SHTI), të cilat, pavarësisht nga një rritje e dukshme e pikëve, tregojnë hapësirë të konsiderueshme për përmirësim.

3.2.3 UNECE¹¹

Barrierat Rregullatore dhe Procedurale të Tregtisë në Republikën e Shqipërisë (2016) është studimi më i konsoliduar që përmbledh gjetjet kryesore për vlerësimin e nevojave tregtare, duke ofruar një analizë sistematike të barrierave rregullatore dhe administrative të tregtisë në vend. **Ai ka nxjerrë në pah pasojat e këtyre barrierave për konkurrencën e eksporteve të vendit dhe integrimin rajonal dhe për këtë ka dhënë rekomandime të orientuara drejt veprimit që kanë të bëjnë me çështjet që lidhen me:** (a) nevojën për të kaskaduar më mirë legjislacionin parësor dhe dytësor

¹⁰ <https://westernbalkans-competitiveness.oecd.org/economies/>

¹¹ Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën <https://unece.org/trade/publications/regulatory-and-procedural-barriers-trade-republic-albania-ecetrade427>

⁹ <https://www.oecd.org/countries/republicofnorthmacedonia/sme-policy-index-western-balkans-and-turkey-2022-b47d15f0-en.htm>

për tregtinë tek operatorët ekonomikë; (b) nevoja për më shumë transparencë të rregullave dhe rregulloreve të përditësuara dhe zbatuara në dogana; (c) heqjen e tarifave të panevojshme në transport dhe logjistikë; (d) harmonizimin e mëtejshëm të rregulloreve teknike; (d) rritjen e kapaciteteve për të rritur standardizimin, harmonizimin dhe akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut si shtyllat kryesore të infrastrukturës së cilësisë, etj.

3.2.4 Një pasqyrë e sfidave të identifikuar nga komuniteti i biznesit gjatë viteve 2015-2023 në lidhje me standardet dhe cilësinë. Me qëllim evidentimin sistematik të problemeve në klimën e biznesit në vend, Sekretariati mban një bazë të dhënash të brendshme mbi *Klimën e Investimeve dhe Problematikat e Biznesit*. Baza e të dhënave rendit raste dhe probleme konkrete, duke përfshirë ato që lidhen me: (a) sfidat për rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare; (b) barrierat tarifore dhe jotarifore të tregtisë ndërkombëtare; (c) kapacitetet institucionale dhe rregullatore; (d) monitorimin e funksionimit të tregjeve specifike si ndërtimi; (d) standardizimin dhe akreditimin; (e) laboratorët e akredituar dhe besueshmëria e tyre. Këto raste janë evidentuar nga takime të drejtpërdrejta, fokus grupe dhe indekse kombëtare dhe ndërkombëtare të vlerësimit të klimës së biznesit gjatë viteve 2015-2023.

Specifike. Sekretariati ka shqyrtuar gjithashtu raporte përkatëse të donatorëve të tjerë si “*Gatishmëria e biznesit shqiptar për procesin e anëtarësimit në BE – Një analizë e boshllëkut të njohurive dhe vlerësimi i nevojave të përgatitur nga ACIT (2021)*” – duke theksuar se bizneset kanë njohuri të ulëta për tregun e përbashkët,

kur bëhet fjalë ndaj kostove dhe përfitimeve nga procesi i anëtarësimit në BE, ndërkohë që, ata pranojnë se kostot kryesore të kompanisë së tyre lidhur me anëtarësimin në BE kanë të bëjnë me përshtatjen me rregulloret dhe standardet e BE-së. Kjo ka shkaktuar pështjellim dhe pasiguri tek ta, sa i përket të ardhmes dhe gatishmërisë së tyre.¹²

3.2.5 Barrierat kryesore tarifore dhe jotarifore tregtare për operatorët ekonomikë shqiptarë

Më poshtë janë disa nga barrierat tregtare të identifikuar nga takimet e KI me biznese dhe burime mediatike. Sekretariati nuk mundi të përcaktojë një listë shteruese të barrierave tregtare në bazë sektoriale dhe/ose vendeve:

- » Kërkesa për noterizimin e analizave fitosanitare
- » Çmimet e referencës
- » Tarifat e skanimit
- » Taksa për plastikën
- » Akciza për produkte të caktuara (birrari)
- » Licencat, certifikimet dhe standardizimet
- » Kuotat: Ndërkohë që nuk ka barriera jotarifore për importet në Shqipëri, përveç kuotave ose kontrolleve të lidhura me disa marrëveshje shumëpalëshe ose dypalëshe me vende të tjera, perceptimi nga bizneset është se ka më shumë kufizime kuotash kur eksportohet në vende të tjera.

Më shumë informacion mund të gjeni në faqen zyrtare të Komitetit Kombëtar të Lehtësimit të Tregtisë¹³, i cili është organi i dedikuar për të bërë transparencë dhe për të dhënë informacionin e inventarit të tarifave dhe pagesave të zbatueshme për importet dhe eksportet shqiptare.

12 Faqe 21 - ACIT (2021)

13 <https://tregtia.gov.al/index.php/en/library/raporte-studime-te-komitetit>

KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Ekzistenca e infrastrukturës së cilësisë është një parakusht për integrimin e ngushtë të ekonomive në zhvillim në zinxhirët globalë të vlerës. Garantimi i konkurrencës në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare siguron që ndërmarrjet të mund të ruajnë tregjet e tyre kombëtare, nga ana tjetër, qasja në tregje të reja u lejon ndërmarrjeve të zgjerohen. Një infrastrukturë cilësie funksionale e aksesueshme nga operatorët ekonomikë do të ndikojë që prodhuesit shqiptarë të kenë akses në një treg më të madh për produktet dhe shërbimet e tyre, me kosto më të ulëta dhe me më pak pengesa administrative, ndërsa në të njëjtën kohë do të reduktojë ndjeshëm kohën e tregtisë.¹⁴ Kuadri ligjor për infrastrukturën e cilësisë mbulon disa shtylla: (a) standardizimin, (b) harmonizimi, (c) akreditimi, (d) metrologjia,

dhe (e) mbikëqyrja e tregut. Për qëllime të Notës Teknik, ne e kemi fokusuar analizën/shqyrtimin tonë në sa vijon:

Standardizimi: Ligji nr. 9870/2008 “Për standardizimin” (i ndryshuar) zbatohet për standardet e hartuara dhe të miratuara në të gjithë sektorët e ekonomisë, me përjashtim të atyre standardeve të hartuara, miratuara dhe miratuara nga shoqëritë, agjencitë dhe/ose organizatat e pavarura. Qëllimi i aktivitetit të standardizimit është ndër të tjera të rrisë nivelin e sigurisë së produkteve dhe proceseve, të përmirësojë efektivitetin e produkteve, të kontrolleve të ndryshme, të sigurojë përputhshmëri dhe ndërveprueshmëri dhe të ndihmojë në heqjen e barrierave teknike në tregtinë ndërkombëtare. Megjithatë standardet kombëtare janë vullnetare, ato shërbejnë si bazë për operatorët ekonomikë për të provuar përputhshmërinë dhe konformitetin në lidhje me produktet dhe shërbimet e tyre.

14 Ky është një nga synimet kryesore të Strategjisë Ndërsëktoriale “Për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2023-2030” miratuar me Vendimin e KM nr. 326 datë 29.05.2024

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) është organi kombëtar i standardizimit në Republikën e Shqipërisë për hartimin, miratimin, miratimin dhe publikimin e standardeve në të gjithë sektorët e ekonomisë. DPS-ja është Autoriteti Kombëtar i Notifikimit dhe Pika Kombëtare e Referimit në OBT dhe në CEFTA për projektstandardet, projektregullat teknike dhe projekt-procedurat e vlerësimit të konformitetit me ndikim në tregti. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit është Autoriteti Kombëtar i Notifikimit dhe Pika Kombëtare e Referimit në OBT për masat sanitare dhe fitosanitare me ndikim në tregti. Autoriteti Kombëtar i Njoftimit, gjatë ushtrimit të këtij funksioni, informon periodikisht njësinë e OBT-së pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë, për çdo njoftim të saj në OBT dhe CEFTA.

Akreditimi: Si procedurë me të cilën një organ i autorizuar vlerëson kompetencën e një organizmi të vlerësimit të konformitetit për të kryer detyra specifike si testimi, kalibrimi, certifikimi dhe inspektimi. Kompetenca është çelësi për të garantuar transparencën, besueshmërinë dhe efikasitetin e shërbimeve të ofruara nga Organet e Akredituara të Vlerësimit të Konformitetit. Fusha e akreditimit rregullohet me ligjin nr. 116/2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit". Sipas ligjit, vlerësimi i konformitetit është procesi që provon nëse janë përmbushur kërkesat e përcaktuara për një produkt, proces, shërbim, sistem, person ose organ.

Procesi i mësipërm monitorohet dhe administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e cila kryen aktivitetet e mëposhtme:

- » Bashkëpunon me organet kombëtare të akreditimit në vende të tjera për arritjen e marrëveshjeve të njohjes reciproke, rajonale ose ndërkombëtare, ose për të arritur marrëveshje dypalëshe.
- » Këshillon administratën shtetërore për çështje që lidhen me akreditimin dhe vlerësimet e tjera të kompetencave teknike për kryerjen e procedurave të vlerësimit të përputhshmërisë me standardet dhe rregulloret teknike.
- » Mban, përditëson dhe jep të dhëna për statusin e akreditimit të organeve të akredituara.
- » Bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit, Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit, me ministritë përkatëse dhe me shoqatat e interesuara për çështjet e akreditimit.
- » Kryen trajnime në fushën e akreditimit.
- » Ndërmerr aktivitete në fushën e krahasimeve ndërlaboratorike dhe testeve të aftësisë.
- » Merr të dhëna nga organet e akreditimit të vendeve të tjera për organizatat e akredituara që kryejnë veprimtari në Shqipëri.

Mbikëqyrja e Tregut: Ligji nr. 10489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore."¹⁵ Ai parashikon të drejtat dhe detyrimet e operatorëve ekonomikë, sipas rolit dhe përgjegjësisë së tyre në zinxhirin e furnizimit për vendosjen e produkteve në treg, për të garantuar dhe siguruar përputhjen e tyre me kërkesat ligjore që lidhen me to. *Ky ligj zbatohet për të gjitha produktet joush-*

¹⁵ Ndryshuar me ligjin 17/2013.

qimore, për të cilat nuk ka një kuadër tjetër të veçantë ligjor dhe institucional. Kërkesat ose parimet e përgjithshme të përcaktuara në këtë ligj shërbejnë si dispozita plotësuese të legjislacionit të posaçëm, kur ky i fundit nuk parashikon këto kërkesa ose parime. Ky ligj nuk zbatohet për substancat kimike që i nënshtrohen regjistrimit dhe/ose autorizimit paraprak dhe produkteve kozmetike. Dispozitat e këtij ligji janë të rëndësishme jo vetëm në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, por edhe në rritjen e ndërgjegjësimit dhe nivelit të gatishmërisë së operatorëve ekonomikë për standardet e aplikueshme të kërkuara si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë të BE-së. Për shembull, ligji parashikon disa rregulla në lidhje me markimin CE. Kur prodhuesi e vendos produktin në treg, ai siguron që ky produkt të jetë projektuar dhe prodhuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin përkatës për këtë lloj produkti. Prodhuesi harton dokumentacionin teknik dhe kryen procedurat e vlerësimit të konformitetit të zbatueshme për këtë produkt. Kur nga këto procedura vërtetohet përputhshmëria e produktit me kërkesat në fuqi, prodhuesi harton deklaratën EC të konformitetit dhe vendos/fikson shenjë të konformitetit.

Ligji nr. 10480, datë 17.11.2011 "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore" zbatohet për produktet e konsumit, ku nuk ekziston legjislacion i posaçëm përkatës për to. Ai parashikon kërkesën e detyrueshme të prodhuesve dhe shpërndarësve që duhet

të sigurojnë për konsumatorët fundorë. Për shembull, ata janë të detyruar t'u ofrojnë konsumatorëve të gjithë informacionin përkatës për produktin në gjuhën shqipe. Gjithashtu, prodhuesit dhe shpërndarësit, brenda kufijve të veprimtarisë së tyre përkatëse, janë të detyruar të monitorojnë sigurinë e produkteve të vendosura në treg, përputhjen e tyre me kërkesat e përgjithshme të sigurisë, veçanërisht monitorimin dhe ndjekjen e ankesave të ofruara nga konsumatorët për rreziqet e produktit, të sigurojë informacionin e nevojshëm për gjurmueshmërinë e origjinës së produktit, si dhe të bashkëpunojë me strukturën përgjegjëse në veprimet e ndërmarra për shmangien e rreziqeve.

Funksionet e mbikëqyrjes së tregut në Shqipëri kryhen nga ISHMT, e cila është përgjegjëse për kryerjen e aktiviteteve të mbikëqyrjes së tregut me qëllim që të sigurojë që produktet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe të sigurojnë mbrojtjen e interesit publik të mbuluar nga ai legjislacion. SIMS mbulon aktivitetet e mbikëqyrjes së tregut në fushën e:

- » Mbrojtjes së konsumatorit, në përputhje me përcaktimin e legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit.
- » Mbrojtjes së pronësisë industriale, në përputhje me përcaktimin e legjislacionit për të drejtat e pronësisë industriale
- » Mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të ngjashme, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit përkatës.
- » Inspektimit të metrologjisë, në përputhje me përcaktimin e legjislacionit për metrologjinë.
- » Etiketimit për konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve që ndikojnë në energji, në përputhje me përcaktimin e


legjislacionit për informacionin në lidhje me konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve që ndikojnë në energji.

» Detergjentët e vendosur në treg, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për detergjentët.

ISHMT e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me legjislacionin për inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe legjislacionin e veçantë në fuqi në secilën prej fushave të inspektimit, si dhe çdo përgjegjësi tjetër të përcaktuar me ligj ose akt nënligjor.

Duke iu referuar raporteve ndërkombëtare të vlerësimit, Shqipëria duket se është në një bazë të mirë të performancës në shumicën e dimensioneve konkurruese, me disa përjashtime. Angazhimet e fundit të ndërmarra si pjesë e agjendës së reformave ballkanike mbeten mjaft ambicioze veçanërisht përsa i përket *ristrukturimit të portofolit të eksporteve, niveleve të ulëta të kapaciteteve prodhuese të industrisë dhe sofistikimit të biznesit, pasuar nga kapacitetet e ulëta profesionale institucionale*

Figura 1. Eksportet shqiptare dhe vlera e shtuar sipas sektorëve




16 Banka Botërore, "Ensuring Quality to Gain Access to Global Market"

dhe njerëzore të nevojshme për mirëfunksionimin e infrastrukturës cilësore. Por "pa një sistem infrastrukturor cilësor kompetent dhe efektiv, mund të jetë e vështirë të rritet produktiviteti; të zbatohet rregulloret e duhura teknike (të rëndësishme për mbrojtjen e konsumatorëve dhe për sigurinë dhe shëndetin e popullatës, faunës dhe florës dhe mjedisit); dhe të inovojë me sukses, duke rezultuar që vendi të jetë më pak konkurrues në tregjet globale."

Për të arritur objektivat e tij strategjike të vendit për zgjerimin dhe diversifikimin e eksporteve, do të kërkohej gjithashtu përpjekje të veçanta nga sektori privat për të marrë përsipër rreziqe dhe për të investuar në aktivitete me vlerë të shtuar, nëpërmjet përmirësimit të njohurive të tyre *mbi kapacitetet e gjelbra, digjitale dhe të qëndrueshme*. Siç është përmendur tashmë, për të përballuar të gjitha këto hapa, sipërmarrësit, veçanërisht NVM-të, duhet të mbështeten për të mësuar se si të investojnë në përvetësimin e metodologjive të reja të punës për të përmbushur kërkesat ndërkombëtare të sigurisë dhe cilësisë.

Vlera e shtuar sipas aktivitetit ekonomik



Burimi: INSTAT

Figura 2. Performanca e kompanive

	Shqipëria				Evropa dhe Azia Qendrore (mesatare)	Vende me të ardhura të larta-të mesme (mesatare)
	Të gjitha kompanitë	Vogla (1-19)	Mesatare (20-99)	Mëdha (>100)	Të gjitha kompanitë	Të gjitha kompanitë
Pjesa e kompanive që përdorin teknologji të licencuar nga një kompani e huaj	15.5	15	11.6	25	17.1	15.3
Pjesa e kompanive me një certifikatë cilësore të njohur ndërkombëtarisht	13.2	8.1	20.6	39	20.4	14.3
STATUSI I TREGTISË DHE EKSPORTIT						
Pjesa e kompanive që eksportojnë drejtpërdrejt të paktën 10% të shitjeve vjetore	14.9	4.5	30.6	67.2	16.8	11.8
Pjesa e kompanive që eksportojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi të paktën 10% të shitjeve vjetore	16.4	6.0	31.7	71.3	21.6	16.3

Burimi: BB, Anketa e kompanive, 2019

GJETJE KRYESORE NGA ANKETIMI

Ndërgjegjësimi dhe rëndësia e standardeve

- Kompanitë përgjithësisht ndihen të painformuara si për legjislacionin e përgjithshëm ashtu edhe për atë specifik në lidhje me pajtueshmërinë me standardet, rregulloret teknike dhe mbikëqyrjen e tregut.
- Kompanitë pranojnë rëndësinë e aplikimit të standardeve, 9 nga 10 kompani, veçanërisht në turizëm, industri dhe bujqësi, njohin vlerën e standardeve në aktivitetet e tyre.

Investimi në cilësi

- Përafërsisht 50% e kompanive synojnë të hyjnë në tregun e BE-së dhe janë të gatshme të investojnë në përmirësimin e cilësisë së produkteve të tyre, ndërsa rreth 20% nuk mund të përballojnë investime të tilla. Kompanitë e mbetura janë të kënaqura me tregtimin në tregjet jashtë BE-së.

Sfidat me të cilat përballen kompanitë:

- Sfidat kryesore në arritjen e standardeve lidhen me mungesën e kualifikimit, ekspertizës dhe njohurive mbi standardet dhe përfitimet e tyre, mungesën e mbështetjes institucionale, praktikat kulturore dhe tradicionale dhe kërkesa e pamjaftueshme e tregut për produkte të standardizuara, si edhe kostot e larta.

Aksesi në informacion

- Mbi 60% e kompanive e kanë të vështirë të aksesojnë informacion në lidhje me rregullat teknike, standardizimin, akreditimin, vlerësimin e konformitetit, metrologjinë dhe mbikëqyrjen e tregut.
- Firmat konsulente dhe interneti konsiderohen si burimet kryesore të informacionit mbi cilësinë e rregullimit teknik të produkteve.

Shërbimet e Konsulencës

- Për shkak të vështirësive në gjetjen e informacionit të duhur, 2 nga 5 kompani u drejtohen firmave konsulente në lidhje me informacionin e nevojshëm mbi standardet dhe cilësinë.
- Një shumicë dërrmuese (80%) e kompanive e shohin të nevojshme konsulencën profesionale për të përmbushur standardet dhe rregullat e BE-së.

Mbështetje për një portal të vetëm informacioni

- Një shumicë e konsiderueshme e kompanive (84%) mbështesin krijimin e një portali të vetëm për të ofruar informacion të plotë mbi kërkesat e hyrjes në treg.
- Eksportuesit advokojnë në mënyrë specifike për një pikë të vetme kontakti për informacion të përditësuar mbi ek-

sportimin në tregun e BE-së, të integruar, idealisht, në dhomat e tregtisë ose shoqatat e biznesit.

Praktikat e inspektimit

- Rreth 70% e kompanive të anketuara i janë nënshtruar inspektimeve, ku afro 50% kanë raportuar praktika të parregullta, përfshirë korrupsionin dhe shkeljet procedurale.
- Vetëm 34% e kompanive i janë nënshtruar vlerësimit të konformitetit dhe 40% besojnë se organet vlerësuese janë akredituar.

Besimi në Certifikimin dhe Laboratorët

- Ndërsa 40% e kompanive besojnë se dokumentet kombëtare të vlerësimit të konformitetit njihen nga vendet importuese, 30% e tyre i shohin laboratorët e akredituar vendas si jo të besueshëm.
- Vetëm 1 në 10 kompani kanë laboratorë të brendshëm dhe pajisje teknologjike, por ato që kanë në përgjithësi kanë personel të kualifikuar për t'i përdorur ato.

Zhvillimi i politikave dhe mbështetja institucionale

- Nuk ka politika të mirë menduara mbi sektorët prioritarë që synojnë mbështetjen e prodhuesve vendas, përmirësimin e konkurrencës në tregun shqiptar dhe përgatitjen e prodhuesve për të hyrë në tregun e BE-së (rasti i produkteve të ndërtimit).

Dialog dhe Bashkëpunim

- Ekziston një mungesë e dukshme e dialogut ndërmjet operatorëve ekonomikë, dhomave të tregtisë, shoqatave të biznesit dhe autoriteteve publike lidhur me sfidat për përfitim të certifikatave të konformitetit.

Nga këndvështrimi institucional, institucioni kryesor që drejton dhe koordinon reformat me synim rritjen e aftësisë së kompanive shqiptare për të përmbushur standardet ndërkombëtare dhe për të qenë konkurruese në tregjet e huaja është MEKI. Ky rol është formësuar nga legjislacioni primar¹⁷ dhe sekondar si dhe nga udhëheqja që ka ministria në lidhje me sa vijon: (1) ndjekja e reformave dhe masave me Komisionin e BE-së në kuadër të kapitullit 1, “Lëvizja e Lirë e Mallrave”. Ky kapitull mbulon parimin e lëvizjes së lirë të mallrave, që do të thotë se produktet duhet të qarkullojnë lirshëm nga një pjesë e Bashkimit Evropian në tjetrin. Legjislacioni i harmonizuar evropian i produkteve, i cili duhet të transpozohet, përfaqëson pjesën më të madhe të *acquis* sipas këtij kapitulli, duke përfshirë fusha të tilla si standardizimi, vlerësimi i konformitetit, akreditimi, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut; (2) për koordinimin e politikës tregtare dhe lehtësimin e tregtisë përmes udhëheqjes së Komitetit Kombëtar të Lehtësim-it të Tregtisë, objektivi kryesor i të cilit është të veprojë si një forum për përmirësimin e procesit të politikave tregtare dhe zbatimin e tyre, lehtësimin e tregtisë dhe përcaktimin e drejtimeve kryesore të lehtësimit të tregtisë; (3) zbatimi dhe monitorimi i BIDS 2021-2027 i zhvilluar në përputhje me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), Programin e Reformës Ekonomike (ERP), Planin e Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal (TPR) 2021-2024 për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Strategjia e re e BE-së për NVM-të. Si një element thelbësor i BIDS përgatitja e Strategjisë së Eksportit pritet të formësojë më tej kërkesat për kompanitë shqiptare në përpjekje për të konkurruar në tregjet e huaja.

¹⁷ VKM nr. 30, datë 17.1.2024 “Për përcaktimin e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”

GJETJE KRYESORE DHE ANALIZA

Gjetjet e paraqitura në këtë dokument pune burojnë nga një analizë e çështjeve të ngritura nga komuniteti i biznesit. Gjetjet janë përpunuar bazuar në reagimet e marra nga një anketim online me 143 kompani, takime 8 me përfaqësues të industrisë prodhuese, kryesisht eksportues dhe tre fokus grupe me Shoqatën e Biznesit Grek në Shqipëri, Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë dhe Shoqatën e Ndërtuesve. Përveç kësaj, Sekretariati është përpjekur të shfrytëzojë sa më shumë një qasje sektoriale për të identifikuar çështjet kryesore sektoriale. Për të siguruar një perspektivë globale, këto gjetje u diskutuan paraprakisht me institucionet përkatëse publike përgjegjëse për adresimin dhe ndërmarrjen e hapave për zgjidhjen e tyre.

A. Identifikohet një mungesë në të dhënat institucionale (për produktet jo-ushqimore) për operatorët ekonomikë vendorë me përparësi konkurruese dhe potencialë për eksport. Sekretariati nuk ishte në gjendje të gjente të dhëna zyrtare për prodhuesit shqiptarë bazuar në

aktivitetet ekonomike për të identifikuar eksportuesit e mundshëm. Kjo çështje u theksua edhe gjatë takimeve me agjencitë qeveritare dhe dhomat e tregtisë/shoqatat e biznesit. Referuar Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, Strategjia e Eksportit¹⁸ pritej të finalizohet në fund të vitit 2022.

B. Ndërsa Raporti i BE-së njeh suksesin e Shqipërisë në harmonizimin e legjislacionit shqiptar me atë evropian, duket se ka mungesë ndërgjegjësimi midis kompanive për legjislacionin horizontal. Gjithashtu, kompanitë nuk shfaqin një ndërgjegjësim më të fortë as të legjislacionit që lidhet me aktivitetet e tyre specifike ekonomike.

(1) 68% e kompanive të anketuara (me aktivitet në prodhim, tregti dhe ndërtim) ose shtatë nga 10 kompani nuk janë të vetëdijshëm për të drejtat dhe detyrimet e tyre në lidhje me përgjegjësitë brenda zinxhirit


¹⁸ Strategjia e eksportit nënkuptonte: (i) Identifikimin e produkteve, shërbimeve dhe tregjeve premtuese për eksport, me fokus në rritjen e sofistikimit të eksporteve, dhe (ii) Vlerësimi i mundësive për promovimin e mëtejshëm të eksportit dhe masat lehtësuese (p.sh. eksplorimi i ofruesve të marketingut digjital.

të furnizimit për vendosjen e produkteve të tyre në treg, siç parashikohet në Ligjin 10489/2011 “Për Tregtinë dhe Mbikëqyrjen e Tregut të Produkteve Jo ushqimore” për operatorët ekonomikë në treg. Ky konstatim u mbështet më tej nga takimet tona individuale me kompani të sektorëve të ndryshëm joushqimor të ekonomisë.

(2) E njëjta situatë vërehet edhe kur pyeten për legjislacion specifik që lidhet me aktivitetet e tyre ekonomike apo rolet në treg, megjithëse përgjigja është disi më pozitive. Më shumë se gjysma e kompanive nuk njohin rregulloret specifike që kanë të bëjnë me aktivitetin e tyre ekonomik dhe/ose rolin në zinxhirin e furnizimit. Këto shifra të ulëta të perceptimit për njohjen e bizneseve me kërkesat e detyrueshme ligjore për produktet e tyre mund të tregojnë se jemi ende larg përmbushjes së standardeve të një tregu të lirë, të drejtë dhe konkurrues. Për më tepër, kjo mund të sugjerojë gjithashtu dobësi në mirëfunksionimin e autoriteteve shtetërore përmbartimore dhe inspektorateve. Në takimet tona individuale me operatorët ekonomikë, kjo mungesë njohjeje i atribuohet edhe mbikëqyrjes së dobët të tregut vendor dhe informalitetit. Sektorët me njohuri solide të legjislacionit specifik përfshijnë kryesisht industrinë nxjerrëse dhe përpunuese, kryesisht për shkak të marrëdhënieve të tyre me partnerët ndërkombëtarë në eksport.

Figura 3. Ndërgjegjësimi mbi legjislacionin horizontal


A jeni në dijeni mbi të drejtat dhe detyrimet e operatorëve ekonomikë, sipas rolit dhe përgjegjësisë së tyre në zinxhirin e furnizimit për vendosjen në treg të produkteve që burojnë nga Ligji 10489/2011?



Burimi: Anketa e Sekretariatit, maj-qershor 2024

Figura 4. Ndërgjegjësimi mbi ligjet dhe rregulloret specifike

A jeni në dijeni mbi kërkesa specifike në legjislacionin në fuqi për produktet e prodhuar/tregtuar sipas aktivitetit tuaj ekonomik (lëndë e parë/të futura në zinxhirin e krijimit të vlerës)?



Burimi: Anketa e Sekretariatit, maj-qershor 2024

C. Për shkak të afërsisë me tregun e vetëm të BE-së, kompanitë e pranojnë rëndësinë e prodhimit dhe tregtimit të produkteve që plotësojnë standardet, megjithëse e pranojnë se procesi është sfidues.

- (3) Ekziston një dakortësim (rreth 93%) nga të gjithë operatorët ekonomikë se aplikimi i standardeve është i rëndësishëm/shumë i rëndësishëm. Pra, nëntë nga dhjetë kompani i konsiderojnë standardet si shumë të vlefshme në operacionet e tyre, veçanërisht në turizëm, industri nxjerrëse, TIK dhe bujqësi dhe ushqim.
- (4) Tregu i përbashkët evropian duket se është motivimi kryesor për kompanitë për të investuar në infrastrukturën cilësore të produkteve të tyre të

prodhuara ose të tregtuara. Pra (55%) ose më shumë se një në dy kompani janë të gatshme të investojnë në cilësi për shkak të aspiratave për të eksportuar në tregun e BE-së, ndërsa një në pesë kompani nuk mund të investojë në prodhim me standardet e BE-së për shkak të kostove të lidhura. Ndërkohë, afërsisht (18%) një në pesë kompani nuk dëshiron të investojë pasi është e kënaqur me prodhimin dhe tregtimin në tregjet e brendshme. *Vlen të përmendet se 85% e kompanive në industrinë përpunuese kanë një perspektivë pozitive për hyrjen në tregun e BE-së, ndërsa vetëm 56% e kompanive në sektorin e produkteve të ndërtimit ndajnë këtë ndjenjë pozitive për hyrjen në tregun e BE-së.*

Figura 5. Rëndësia e standardeve


Sa të rëndësishëm e konsideroni respektimin e standardeve të cilësisë në produktet që prodhoni/ tregtoni?



Burimi: Anketa e Sekretariatit, maj-qershor 2024

Figura 6. Investime në përputhje me standardet dhe cilësinë

A mendoni të investoni në drejtim të përputhshmërisë me standardet dhe rritjes së cilësisë së produkteve:



Burimi: Anketa e Sekretariatit, maj-qershor 2024

- (5) Sfidat kryesore në arritjen e standardeve dhe cilësisë më të lartë lidhen me mungesën e mbështetjes institucionale, me mungesën e kualifikimit, ekspertizës dhe njohurive mbi standardet dhe përfitimet e tyre, kostot e larta, si edhe praktikatat kulturore dhe tradicionale dhe kërkesën e pamjaftueshme të tregut për produkte të standardizuara. Sa më sipër përforcon konstatimin e mëparshëm se tregu i brendshëm ende vuan nga konkurrenca e pandershme, me gjasë për shkak të problemeve me zbatimin e ligjit nga institucionet dhe inspektoriatet përkatëse shtetërore.

Po, sepse dua të futem në një treg me potencial më të madh evropian





Figura 7. Sfidat me të cilat përballen kompanitë

Cilat janë disa sfida me të cilat përballen NVM-të shqiptare kur përpiqen të prodhojnë/tregtojnë me standarde?



Burimi: Anketa e Sekretariatit, maj-qershor 2024


D. Operatorët ekonomikë në treg perceptojnë mungesën e bashkëpunimit institucional dhe harmonizimit të aktiviteteve të tyre, së bashku me mungesën e fokusit dhe informacionit të centralizuar për infrastrukturën cilësore.

(6) Pajtueshmëria me kërkesat dhe standardet e detyrueshme të sigurisë është e lidhur ngushtë me ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve, veçanërisht prodhuesve dhe importuesve, për rëndësinë e respektimit të rregulloreve teknike dhe infrastrukturës cilësore, duke përfshirë akreditimin, standardizimin, metrologjinë dhe mbikëqyrjen e tregut. Sipas të dhënave të sondazhit tonë, kompanitë hasin sfida në aksesin e informacionit gjithëpërfshirës dhe lehtësisht të menaxhueshëm në lidhje me aspekte të ndryshme të infrastrukturës së cilësisë së produktit, duke përfshirë rregulloret teknike, standardizimin, akreditimin, vlerësimin e konformitetit, metrologjinë dhe mbikëqyrjen e tregut. Më shumë se (63%), tre nga pesë kompani raportojnë se marrja e informacionit të nevojshëm nuk është e drejtpërdrejtë, vlerësim ky i përsëritur nga kompanitë edhe gjatë takimeve individuale dhe mbledhjeve fokus-grup. Kjo ndoshta lidhet me njohuritë e tyre të kufizuara mbi këtë temë, por tregon gjithashtu se institucionet shtetërore kanë hapësirë për përmirësime në strukturimin e

informacionit për ta përcjellë atë në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme tek operatorët ekonomikë.

Figura 8. Lehtësia e gjetjes së informacionit mbi cilësinë

A mendoni se informacioni në lidhje me infrastrukturën e cilësisë së produkteve (rregulloret teknike, standardizimin, akreditimin, vlerësimin e konformitetit, metrologjinë dhe mbikëqyrjen e tregut) është lehtësisht i aksesueshëm?




Burimi: Anketa e Sekretariatit, maj-qershor 2024

(7) Ndoshta për shkak të sfidave në aksesin e informacionit, kompanitë po mbështeten gjithnjë e më shumë në shërbimet e konsulencës të ofruara nga firmat e konsulencës. Kjo prirje pranohej edhe nga institucionet shtetërore gjatë takimeve tona. Dy nga pesë kompani kërkojnë ndihmë nga firmat e konsulencës për të marrë informacionin e nevojshëm mbi standardet dhe cilësinë e produktit.

Figura 9. Ku drejtohen kompanitë për informacion mbi standardet e produktit

Nëse nuk keni informacion ose kërkon informacionin më të fundit ku drejtoheni fillimisht për marrjen e informacionit:




Burimi: Anketa e Sekretariatit, maj-qershor 2024

(8) Ndërsa e pranojnë se kanë njohuri dhe ndërgjegjësim të kufizuar, operatorët ekonomikë vlerësojnë se konsulenca luan një rol jetik në respektimin e standardeve dhe kërkesave thelbësore të BE-së për cilësinë e produktit, me 67% të kompanive që e konsiderojnë atë shumë thelbësore.

Figura 10. Nevoja për konsulencë

Për të arritur kërkesat e standardeve apo rregulloreve të brendshme apo të BE-sa sa të nevojshme e vlerësoni marrjen e njohurive dhe të konsulencës profesionale:




Burimi: Anketa e Sekretariatit, maj-qershor 2024

(9) Operatorët ekonomikë advokojnë nevojën për një “dritare” të vetme (faqe interneti, portal ose platformë të ngjashme) ku ata mund të lundrojnë dhe aksesojnë lehtësisht informacionin përkatës të kërkuar për të hedhur produktet e tyre në treg.

Figura 11. Portali i vetëm

A gjykoni se një portal i tillë (si më sipër) është i domosdoshëm për operatorët ekonomikë në treg?




Burimi: Anketa e Sekretariatit, maj-qershor 2024


(10) Eksportuesit rikonfirmojnë konstatimin e mësipërm, duke pohuar se një dritare e vetme (portal, faqe interneti ose platformë e ngjashme) është thelbësore për të aksesuar të gjithë informacionin përkatës që ka të bëjë me eksportin në tregun e BE-së. Ata advokojnë për ngritjen e një sporteli (helpdesk) për t'i ndihmuar ata në lidhje me procedurat për harmonizimin me standardet e tregut të BE-së dhe kërkesat e cilësisë për produkte të ndryshme në përputhje me aktivitetet e tyre. Ata sugjerojnë që një platformë e tillë duhet të integrohet brenda dhomave të tregtisë ose shoqatave të biznesit.

Figura 12. Portali i vetëm për eksportuesit


EKSPORTUES - A mendoni se një portal i tillë (si më lart) është i domosdoshëm për eksportuesit?



EKSPORTUES - A gjykoni se duhet të krijohet një pikë e vetme kombëtare si kontakt (Helpdesk) për eksportuesit në lidhje me informacionin për harmonizimin me kërkesat e tregut të vetëm të BE-së:



Nëse po, ku mund të vendoset:




Burimi: Anketa e Sekretariatit, maj-qershor 2024

E. Mungon dialogu i fokusuar ndërmjet operatorëve ekonomikë në treg, dhomave të tregtisë/shoqatave të biznesit dhe organizatave publike kombëtare në lidhje me sfidat që lidhen me certifikatat e konformitetit: testimet, inspektimet dhe certifikatat; gjithashtu certifikimi i produkteve sipas rregullave dhe standardeve të BE-së është identifikuar si sfida kryesore.

- (11) 9 nga 10 kompani konfirmojnë mungesën e dialogut në lidhje me certifikatat e konformitetit.

Figura 13. Dialogu për certifikatat e konformitetit

A keni marrë pjesë në forume në baza të rregullta për dialogun ndërmjet organizatave kombëtare të standardeve (NSO) dhe shoqatave të biznesit që përfaqësojnë NMVM-të në lidhje me sfidat për certifikatat e konformitetit (testimin, inspektim, certifikim)?




Burimi: Anketa e Sekretariatit, maj-qershor 2024

- (12) Për sa i përket besueshmërisë së produktit të tyre, pavarësisht nga tregu ku ato operojnë, kompanitë identifikojnë certifikimin e produktit si sfidën e tyre kryesore.

Figura 14. Sfidat në lidhje me besueshmërinë e produktit

Në përpjekjet tuaja, ku keni pasur më shumë sfida në lidhje me besueshmërinë e produktit tuaj:




Burimi: Anketa e Sekretariatit, maj-qershor 2024

F. Vetëm 36% e kompanive eksportuese vlerësojnë pozitivisht njohjen e dokumenteve të vlerësimit të konformitetit të lëshuara nga organet kombëtare të vlerësimit të konformitetit, pavarësisht nga akreditimi i tyre. Ky perceptim midis eksportuesve ka nevojë për verifikim dhe vlerësim të mëtejshëm. *Ndërsa DPA vlerëson kompetencën e një trupe të certifikimit të konformitetit (CAB), ajo nuk garanton që CAB demonstroi vazhdimisht të njëjtin nivel të kompetencës në aktivitetet e përditshme siç është vërejtur gjatë vizitës së auditimit të DPA-së. Mekanizma shtesë të kontrollit dhe mjete monitoruese duhet të propozohen dhe zbatohen nga ministria kompetente (e tregtisë).*

Figura 15. Njohja e dokumenteve të vlerësimit të konformitetit

Nëse eksportoni, a njihen dokumentet e vlerësimit të konformitetit të lëshuara nga organet kombëtare të vlerësimit të konformitetit?




Burimi: Anketa e Sekretariatit, maj-qershor 2024

G. Operatorët ekonomikë theksojnë një mungesë të konsiderueshme të mbështetjes, jo vetëm nga agjencitë qeveritare, por edhe nga shoqatat e biznesit dhe dhomat e tregtisë. Bizneset perceptojnë se dhomat e tregtisë dhe shoqatat e biznesit nuk ofrojnë informacion të përditësuar mbi legjislacionin e produkteve. Gjithashtu, qeveria nuk arrin të mbështesë operatorët ekonomikë me informacionin e nevojshëm dhe ndihmën financiare në këtë fushë

- (13) Sipas perceptimit të biznesit, 7 nga 10 pranuan mungesën e informacionit të përditësuar nga shoqatat e biznesit/dhomat e tregtisë për detyrimet që lidhen me legjislacionin dhe infrastrukturën e cilësisë, standardet dhe 2 nga 10 kompani nuk janë në dijeni nëse një informacion i tillë disponohet.

Figura 16. Informacion nga Dhomat e Tregtisë/shoqatat e biznesit

A ju ofrojnë dhomat e tregtisë/shoqatat e biznesit informacion të përditësuar (p.sh. buletinet) për detyrime që lidhen me infrastrukturën e cilësisë, standardet dhe aktivitetet e standardizimit?




Burimi: Anketa e Sekretariatit, maj-qershor 2024


- (14) Operatorët ekonomikë identifikojnë mungesën e mbështetjes nga agjencitë qeveritare, si në aspektin e informacionit ashtu edhe të ndihmës financiare. Tre nga pesë kompani deklarojnë se qeveria nuk ofron masa për të lehtësuar aksesin në certifikim dhe dy në pesë kompani theksojnë mungesën e asistencës financiare të shtetit për uljen e kostove për përfundimin e standardeve. Ngakonsultimi ynë me biznese individuale dhe dhomat e tregtisë, përfshirë të dhënat nga anketa, evidentohet se një pjesë e konsiderueshme e bizneseve nuk janë në dijeni të ndonjë mbështetjeje nga qeveria, duke evidentuar ose mungesën e interesit ose mungesën e besimit tek institucionet publike përgjegjëse.

Figura 17. Mbështetje nga agjencitë qeveritare

A ofron shteti masa (këshillim, etj.) për të lehtësuar aksesin e NMVM-ve për të certifikuar produktet/shërbimet e tyre?



A ka ndonjë masë financiare shtetërore (p.sh. subvencione) që ul koston e përvetësimit të standardeve për NMVM-të?




Burimi: Anketa e Sekretariatit, maj-qershor 2024

- (15) Mbështetja financiare për pajisjet dhe teknologjinë, thjeshtimi i procedurave për marrjen e certifikatave dhe programet e edukimit dhe trajnimit mbi standardet janë identifikuar si masat kryesore mbështetëse në të cilat qeveria duhet të investojë për të inkurajuar kompanitë të prodhojnë dhe tregtojnë në përputhje me standardet.

Figura 18. Masat nga agjencitë qeveritare

Në opinionin tuaj, çfarë hapash mund të ndërmarrë qeveria shqiptare për të mbështetur NVM-të në prodhimin dhe tregtimin e produkteve që plotësojnë standardet ndërkombëtare?




Burimi: Anketa e Sekretariatit, maj-qershor 2024

Kompanitë janë të ndara në çështjen e kostove për përbushjen e standardeve dhe rregulloreve të brendshme të BE-së. Një në dy kompani beson se qeveria duhet të financojë të gjithë procesin, ndërsa gjysma tjetër është e gatshme të ndajë kostot në mënyrë të barabartë. Duhet theksuar se, në parim, përgjegjësia për certifikimin dhe sigurimin e pajtueshmërisë së produktit me kërkesat ligjore i takon prodhuesit dhe jo shtetit. Fakti që 49% e kompanive presin që shteti të mbulojë plotësisht kostot e pajtueshmërisë së produktit mund të tregojë mungesë motivimi midis bizneseve për të përbushur përgjegjësitë e tyre dhe për të mbetur konkurrues. Shteti mund ta mbështesë këtë proces duke ofruar trajnime ose duke ofruar stimuj fiskalë të justifikuar mirë në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore që mbështet konkurrencën e ndershme.

Figura 19. Biznesi mbi Kostot për përbushjen e standardeve të BE-së

Për të arritur kërkesat e standardeve apo rregulloreve të brendshme apo të BE-së do të ishit të gatshëm të ndanit kostot përkatëse me shtetin?



Burimi: Anketa e Sekretariatit, maj-qershor 2024


H. Inspektimet janë identifikuar si problematike nga kompanitë për shkak të praktikave të parregullta të vëzhguara nga inspektorët. Këto parregullsi përfshijnë kryesisht praktikën e dyshimta korruptive, shkeljet e procedurave të inspektimit dhe mungesën e profesionalizmit dhe paanshmërisë, me inspektorët që shfaqin standarde të paqëndrueshme.

(16) Më shumë se dy në pesë kompani kanë hasur në praktika të parregullta gjatë inspektimeve shtetërore, kryesisht me sjelljet korruptive, shkeljen e procedurave të inspektimit, mungesën e paanshmërisë dhe njohurive teknike si çështjet kryesore të identifikuar.

Figura 20. Biznesi mbi praktikën e parregullta të inspektimit



Praktikat e parregullta nga ana e inspektorateve shtetërore kanë qënë kryesisht lidhur me:




Burimi: Anketa e Sekretariatit, maj-qershor 2024

I. Eksportuesit, me një raport një në dy kompani, përgjithësisht priren të certifikohen, ndërsa vetëm një në katër kompani shprehen se kanë marrë certifikata ISO.

(17) Për shkak të partneriteteve të tyre të biznesit, eksportuesit në përgjithësi kanë nevojë për certifikata ISO për t'u kualifikuar për të nënshkruar kontrata me importues të huaj.

Figura 21. Kompanitë me standarde ISO



Burimi: Anketa e Sekretariatit, maj-qershor 2024

J. Konsultimet tregojnë se Shqipërisë i mungon një organizëm i akredituar për certifikimin e produkteve. Duhet pranuar se ne nuk kemi ende një industri të mirë-formuar brenda fushës së markimit CE. Megjithatë, edhe në sektorët ku ekziston, siç janë produktet e ndërtimit, ekziston legjislacion kombëtar i vjetëruar që nuk është i harmonizuar me acquis të BE¹⁹-së. Si rezultat, ka rregulla të paqarta, që çojnë në një treg të pabarabartë për kompanitë, në disavantazh të konkurrencës në tregun vendas, duke kompromentuar cilësinë e produkteve të ndërtimit në dispozicion dhe duke penguar eksportet në tregun e BE-së.

PËRPJEKJE PËR TË RRIJTUR CILËSISË NËPËRMJET STANDARDIZIMIT

KUTIA 1.

Rasti i turizmit

Kategorizimi dhe Klasifikimi i Strukturave Akomoduese

Ligji 93/2015 parashikonte procesin e kategorizimit dhe klasifikimit të strukturave akomoduese turistike që mungonte në ligjin e mëparshëm. Megjithatë, ky proces për hotelet ka ngecur edhe pse aktet e nevojshme nënligjore janë miratuar në kohë.²⁰ Mungesa e këtij procesi ka sjellë

¹⁹ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32011R0305>.

²⁰ VKM nr. 710 datë 12.10.2016 "Miratimi i Rregullores për Kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Operatorit Turistik"; VKM Nr. 711 datë 12.10.2016 "Miratimi i Rregullores për Kushtet dhe Kriteret e Projektimit dhe Ndërtimit të Strukturës Akomoduese të Ndërtimit"; VKM Nr. 730 datë 20.10.2016 "Miratimi i Rregullores për Kushtet, Kriteret, Tarifat, Kushtet dhe Procedurat e Klasifikimit të Strukturave të Akomodimit".

një situatë kaosi në treg, veçanërisht për hotelet. Disa struktura akomoduese përdorin shenja dalluese (yje) të klasifikimit të cilat nuk përputhen me standardet reale të strukturës ose me nivelin e shërbimit që ofrojnë. Megjithatë, duket se ndërsa ligji 93/2015 përfshinte "bujtina" në konceptet kryesore të ligjit, nuk arriti deri në vitin 2024 të përfshijë apartamentet/vilat si pjesë e "strukturave akomoduese. Amendamentet e fundit përpunohen të trajtojnë çështje që lidhen me informalitetin në sektor dhe të ndërgjegjësojnë në treg rëndësinë e ofertës së përgjegjshme dhe të rregulluar turistike.²¹

KUTIA 2

Sektori i Ndërtimit

Ndryshe nga industritë e tjera joushqimore, duket se në Shqipëri ka një numër të konsiderueshëm ndërmarrje të vogla, të mesme e të mëdha të produkteve të ndërtimit. Megjithatë, gjatë analizës sonë hasëm vështirësi për të gjetur një regjistër apo listë të saktë të këtyre kompanive. Referuar anketimit dhe takimeve me përfaqësues të sektorit të ndërtimit, prodhuesit po operojnë në një mjedis të vetërregulluar, pasi kuadri ligjor përkatës nuk është ende në përputhje me acquis-in e ri të BE-së. Në përgjithësi, për shkak të mungesës së rregulloreve, prodhuesit që prodhojnë për tregun e brendshëm, nuk janë të njohur me procedurat e certifikimit të pro-

²¹ Kjo u trajtua me ligjin nr. 30/2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 93/2015 "Për Turizmin".

dukteve. Më tej, rezultoi se në Shqipëri mungojnë rregulloret lidhur me kërkesat bazë për punimet e ndërtimit²² (rezistenca dhe qëndrueshmëria mekanike, siguria në rast zjarri, higjiena, shëndeti dhe mjedisi, siguria dhe aksesueshmëria në përdorim, mbrojtja nga zhurmat, ekonomia e energjisë dhe ruajtja e nxehtësisë si edhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore). Veprimtaria e aktorëve të sektorit të ndërtimit duket se nuk funksionon me të njëjtat rregulla gjë që shtrembëron konkurrencën dhe ndikojnë në sigurinë e punimeve të ndërtimit në Shqipëri.

Sektori i ndërtimit në Shqipëri udhëhiqet nga disa ligje dhe rregullore kyçe. Këtu përfshihen: ligji nr. 9290, datë 7 tetor 2004, “Për produktet e ndërtimit” dhe ligji nr. 8402, datë 10 shtator 1998, i cili ka të bëjë me kontrollin dhe rregullimin e punimeve të ndërtimit. Përveç këtyre, ka akte nënligjore dhe udhëzime që japin detaje të mëtejshme. *Megjithatë, kuadri ligjor aktual nuk përputhet me rregulloren e re të produkteve të ndërtimit të acquis të BE-së* (<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32011R0305>). Vlerësimi dhe verifikimi i qëndrueshmërisë së performancës së produkteve të ndërtimit, organet e notifikuara, markimi CE dhe kërkesat e tjera, të gjitha këto parime mungojnë në legjislacionin ekzistues shqiptar.

Në thelb, ndërkohë që Shqipëria ka ligje ekzistuese që rregullojnë produktet e ndërtimit, ato nuk përputhen plotësisht me stan-

dardet gjithëpërfshirëse të vendosura nga rregullorja e BE-së në lidhje me marketingun dhe performancën e produkteve të ndërtimit.

Kuadri ligjor aktual në Shqipëri detyron përdorimin e raporteve të testeve nga laboratorë të akredituar për produktet e ndërtimit, të mbështetur nga njëmbëdhjetë laboratorë të akredituar që mbulojnë aspekte të ndryshme. Këta laboratorë u shërbejnë kryesisht ndërtuesve të cilët duhet të respektojnë detyrimet ligjore. Megjithatë, sistemit tonë të infrastrukturës së cilësisë i mungojnë elementë të tjerë thelbësorë për shkak të ligjeve të vjetruara. Konkretisht, Shqipërisë i mungojnë organet e akredituara të certifikimit të produkteve, të cilat nuk kërkojnë me ligj. Për më tepër, jo të gjitha kompanitë i përmbahen standardeve të harmonizuara evropiane, duke rezultuar në mospërputhje me deklaratat e performancës për produktet e ndërtimit. Ndërtimi është një nga sektorët kryesorë të ekonomisë ndërkohë që sektori nuk ka standarde të përditësuara të BE. Sipas anketës dhe takimeve konsultative me sektorin e ndërtimit, prodhuesit po operojnë në një mjedis të vetërregulluar nga vetë ata, pasi kuadri ligjor përkatës nuk është ende në përputhje me *acquis*-in e ri të BE-së. *Ndërgjegjësimi i kompanive të ndërtimit është rritur në lidhje me cilësinë e lëndëve të para dhe nevojën për të testuar cilësinë e tyre.*

- “*Ka kulla të bukura të projektuara nga studio serioze të huaja, por zbatimi ndonjëherë bëhet përmes kompanive vendase të cilat jo gjithmonë respektojnë standardet përkatëse dhe kjo është një çështje shumë delikate.*”

Disa kompani me reputacion zbatojnë vullnetarisht rregullat dhe standardet

e BE-së, veçanërisht ato që eksportojnë në tregun e BE-së. Megjithatë, ky aderim i vendos ato në një disavantazh konkurrues brenda tregut shqiptar, pasi kompanitë e tjera nuk janë të detyruara të ndjekin të njëjtat standarde. Për rrjedhojë, tregu vendas ka një pozitë të pabarabartë për produktet e ndërtimit, duke ndikuar negativisht në konkurrencën e ndershme dhe në ecurinë e përgjithshme të punimeve të ndërtimit në Shqipëri.

Sikundër është përmendur më lart, një sistem funksional i infrastrukturës së cilësisë është element thelbësor i një prej lirive themelore të BE-së - lëvizjes së lirë të mallrave. Procesi i para-anëtarësimit kërkon që vendet candidate të miratojnë të gjithë legjislacionin e BE-së dhe të sigurojnë që çdo legjislacion i transpozuar të zbatohet siç duhet pasi lehtëson tregtinë, eliminon barrierat teknike për tregtinë dhe shmang krijimin e barrierave të ardhshme tregtare. Gjithashtu, zbatimi i nismave rajonale si CEFTA dhe angazhimet politike në kuadër të Ballkanit të Hapur ***synojnë të forcojnë kapacitetet e shteteve anëtare (BB6) për të rritur mundësitë tregtare dhe për të lehtësuar aksesin, jo vetëm në bazë rajonale, por edhe për të lehtësuar aksesin drejt tregjeve evropiane dhe botërore.***

Ndërtimi i një ekosistemi cilësor dhe standard

(infrastruktura cilësore) efikas dhe efektiv është një proces shumë kompleks. Nga një eksperience praktike e biznesit lokal dhe procesit të ardhshëm të anëtarësimit në BE, mirëfunksionimi i tij mbetet thelbësor për konkurrencën lokale, rritjen e aksesit në tregje të reja, stimulimin e produktivitetit dhe inovacionit. Në këtë kontekst, në përputhje me objektivin e studimit, gjetjet e mësipërme ofrojnë evidencë paraprake për debat te fokusuar dhe ndërhyrje të veçanta që do të konsideronin:

- » Nivele të kufizuara të ndërgjegjësimit të biznesit dhe njohurive mbi detyrimet ligjore që duhet të respektohen përkundrejt kërkesave të tregut vendor, ndërkohë që kompanitë e konsulencës konsiderohen si burime të mundshme ndihme.
- » Pritshmëri e madhe në lidhje me mundësitë dhe aksesin në tregun e BE-së, por me frikë nga kostot përkatëse, e ndjekur nga boshllëqet e njohurive dhe ekspertizës, mbështetje e kufizuar institucionale, vështirësi në aksesin e informacionit përkatës.
- » Certifikimi i produktit konsiderohet më problematik për tregjet e brendshme dhe të jashtme.
- » Ka një nivel të ulët të funksionalitetit të tregut dhe besim të kufizuar në institucionet përkatëse të zbatimit dhe monitorimit, kryesisht për shkak të përvojave negative si profesionalizmi i ulët dhe korrupsioni gjatë inspektimeve.

²² BRCW (Kërkesat bazë për punimet e ndërtimit) nuk janë të njëjta në të gjithë Shtetet Anëtare të BE-së dhe nuk janë të njëjta për të gjitha llojet e punimeve (për shembull mund të rregullohet reagimi ndaj zjarrit për të gjitha ndërtesat ose vetëm për ndërtesat tregtare).

REKOMANDIME

Rekomandimet e mëposhtme kërkojnë veprime dhe rol proaktiv si të institucioneve qeveritare ashtu edhe të komunitetit të biznesit. Sikurse KI ka miratuar në rekomandimet e kaluara²³, përmirësimi i praktikave të konsultimit publik mund t'i japë një shtysë cilësisë së legjislacionit parësor dhe dytësor të miratuar në vend, veçanërisht atyre që lidhen drejtpërdrejt me direktivat dhe rregulloret e BE-së që shpesh janë të ndërlikuara, mbartin detaje dhe transpozimi i të cilave kërkon ekspertizë specifike sektoriale. Prandaj, përfshirja më e madhe e aktorëve në fazën e hartimit të legjislacionit në lidhje me cilësinë dhe standardet, do të ndërgjegjësojë, lehtësojë zbatimin dhe do të minimizojë rastet

kur ato dështojnë me zbatimin e legjislacionit dhe janë subjekt i sanksioneve dhe masave kufizuese nga inspektorate të ndryshme.

REKOMANDIM 1

Në nivel strategjik, MEKI duhet: a) të fillojë krijimin e një baze të dhënash me prodhuesit vendas sipas produkteve të tyre, dhe të kryejë analiza gjithëpërfshirëse të detajuara për identifikimin e sektorëve prioritarë/strategjik të cilët kanë potencial konkurrues në vend dhe eksporte; b) të konsiderojë politika mbështetëse në këta sektorë. Kjo bazë të dhënash mund të shërbejë si pikënisje për analiza të mëtejshme nga perspektiva konkurruese lokale dhe duhet të përditësohet çdo vit. Të dhëna të tilla janë të një rëndësie të madhe për MEKI-n për të kryer analizat përkatëse konkurruese për sektor,

²³ KI, Maj 2022- "Konsultimi Publik si një Mjet Efektiv për Përmirësimin e Vendimarrjes dhe Dialogut Biznes-Institucione"- Rekomandimi 1

identifikimin e produkteve/sectorëve prioritarë, problemet e tyre, ndërtimin e politikave/stimujve të duhur apo negociimin e marrëveshjeve në nivel rajonal. Ky proces kërkon edhe përfshirjen e Dhomave të Tregtisë, DPD, shoqatave të biznesit, etj.

REKOMANDIM 2

MEKI merr drejtimin dhe koordinon me institucionet e tjera²⁴, ndërtimin e një faqe interneti/portali të vetëm në dispozicion të publikut, që shërben si një dritare unike informacioni dhe udhëzimi për importin dhe eksportin e produkteve, duke përfshirë kërkesat teknike/rregulloret, procedurat, formalitetet dhe kërkesat, rregullat e origjinës, masat e eksportit²⁵, legjislacioni për mallrat, infrastruktura e cilësisë. Portali duhet të sigurojë qëndrueshmëri e përditësim të informacionit pavarësisht nga riorganizimi në kohë i ministrive (ndarja apo bashkimi i funksioneve në portofolin e tyre) dhe kompanitë e interesuara të mund të gjenin informacion të saktë dhe falas për produktin e tyre. Shembujt portalesh të tilla mund të jenë: [\(1\) Portali i Komisionit Evropian - Access2markets;](#) [\(2\) Genormal - One shop for compliance;](#) [\(3\) Portali i Ministrisë së Ekonomisë në Serbi dedikuar cilësisë dhe sigurisë së produkteve.](#)

REKOMANDIM 3

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë duhet të përshpejtojë transpozimin e Rregullores së re të BE-së për produktet e ndërtimit dhe të përgatisë kërkesat e nevojshme rregullatore për lloje të ndryshme

²⁴ AKSHI, ministritë, agjencitë qeveritare.

²⁵ Kjo duhet të analizohet më tej në kuadër të Portalit të Eksporteve.

të punimeve ndërtimore. Kjo bëhet e domosdoshme sidomos përmes reformës së fundit mbi Axhendën e Gjelbër të BE-së, që përfshin vendet kandidatë.

Shqipëria është i vetmi vend në CEFTA që nuk e ka bërë transpozimin akoma. Me synimin për të arritur një funksionim të duhur të tregut të brendshëm, MIE duhet të përshpejtojë me transpozimin e Rregullores së Produkteve të Ndërtimit (CPR) dhe të përgatisë rregulloret për punimet e ndërtimit. Kjo kërkon koordinim dhe veprime të përbashkëta të institucioneve qeveritare me të gjitha palët e interesuara: kompanitë konsulente, prodhuesit, importuesit, ndërtuesit, organet e vlerësimit të konformitetit, përfaqësuesit e infrastrukturës së cilësisë, etj. Gjithashtu, është e nevojshme të "edukohet" dhe të ndihmohen prodhuesit të "ndërtojnë" website/profile të besueshme me informacionin e nevojshëm që do të mbulonte të dhëna se si të ndërtohet, kërkesat/rregulloret teknike, procedurat, formalitetet dhe kërkesat, rregullat e origjinës, masat e eksportit, legjislacioni për mallrat, infrastruktura e cilësisë duke përfshirë certifikatat e vlerësimit të konformitetit duhet të kenë të dhëna nga prodhuesit.

REKOMANDIM 4

Forcimi i zbatimit të ligjit nga mbikëqyrja e tregut/institucionet shtetërore/inspektoriatet, përmirësimi i procesit të inspektimit si dhe kompetencat dhe integriteti i inspektorëve. Sugjerohen: (1) Kërkesa më të forta, proces i rreptë dhe përzgjedhje transparente e inspektorëve, (2) procesi i monitorimit të inspektorëve të bazohet në modelin e riskut, (3) trajnime dhe vlerësime të shpeshta bazuar në cilësinë e performancës për inspektorët, (4) vendosja e një procedure denoncimi, lejimi i

njoftimeve anonime nga aktorë të ndryshëm (konsumatorë, kompani subjekt i procedurës së inspektimit, etj.) si një mjet ndihmues për fillimin e hetimit nga një strukturë e paanshme lidhur me sjelljet korruptive të raportuara mbi inspektorët, mungesën e kompetencës ose paanshmërinë e tyre gjatë procesit të inspektimit.

REKOMANDIM 5

Dhomat e Tregtisë/Shoqatat e Biznesit duhet të përmirësojnë/forcojnë kapacitetet e tyre për përditësimin e informacionit(ex HUB)në lidhje me rregulloret teknike dhe infrastrukturën cilësore (të gjelbër, digjitale, të qëndrueshme), fillimisht në sektorët prioritarë. Rekomandohet

që këto struktura të marrin masa, të përmirësojnë kapacitetet e tyre, të avokojnë dhe të ofrojnë ekspertizë të brendshme/të jashtme në këtë drejtim për anëtarët e tyre.

REKOMANDIM 6

MEKI duhet të koordinohet me ministritë e tjera përkatëse të linjës dhe institucione publike si MIE, AIDA dhe Dhomat e Tregtisë për të ndërmarrë veprime/fushata ndërgjegjësuere të vazhdueshme për të përmirësuar njohuritë e kompanive në lidhje me legjislacionin e përgjithshëm dhe specifik mbi pajtueshmërinë me direktivat e reja të BE-së për standardet, rregulloret teknike, mbikëqyrjen e tregut, etj.

BIBLIOGRAFIA

- » *Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve miratuar me VKM nr.466 datë 30.07.2021*
- » *VKM nr. 12 datë 11.01.2024 - ERP 2024 – 2026*
- » *Progres Raporti 2023 i BE për Shqipërinë*
- » *OECD: SME Policy Index Western Balkans and Turkey 2022 <https://www.oecd.org/countries/republicofnorthmacedonia/sme-policy-index-ëestern-balkans-and-turkey-2022-b47d15f0-en.htm>*
- » *OECD: Western Balkans Competitiveness Outlook 2024: Albania*
- » *<https://westernbalkans-competitiveness.oecd.org/economies/>*
- » *Strategjia Ndërsektorale “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2023-2030” miratuar me VKM nr. 326 datë 29.05.2024*
- » *Ligji nr. 116/2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit”*
- » *Ligji nr. 10 489, dated 15.12.2011 “Për Tregtimin dhe Mbikëqyrjen e Tregut të Produkteve Jo-ushqimore”*
- » *Ligji nr. 10 480, dated 17.11.2011 “Për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve Jo-ushqimore”*
- » *VKM nr. 710 datë 12.10.2016 “Miratimi i Rregullores për Kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Operatorit Turistik”*
- » *VKM Nr. 711 datë 12.10.2016 “Miratimi i Rregullores për Kushtet dhe Kriteret e Projektimit dhe Ndërtimit të Strukturës Akomoduese të Ndërtimit”*
- » *VKM Nr. 730 datë 20.10.2016 “Miratimi i Rregullores për Kushtet, Kriteret, Tarifat, Kushtet dhe Procedurat e Klasifikimit të Strukturave të Akomodimit”*
- » *Ligji nr. 93/2015 “Për Turizmin”*
- » *Ligji nr. 9290 dated 07.10.2004 “Për Produktet e Ndërtimit”*
- » *World Bank, Enterprise Survey*
- » *Creating Markets in Albania, World Bank 2022*
- » *INSTAT*

SHTOJCA I – PYETËSORI I ANKETËS SË BIZNESIT

"Sfidat: Krijimi i Mjedisit Rregullator Lehtësues Për të Rritur Konkurrencën e NVM-ve në Treg Përmes Harmonizimit me Standardet e BE-së"

1. Mosha e kompanisë suaj;
2. Qarku ku kryeni aktivitetin tuaj;
3. Forma e organizimit të biznesit tuaj;
4. Aksionari/Partneri/Pronari më i madh i biznesit tuaj është:
5. Madhësia e biznesit tuaj sipas xhiros së vitit të kaluar. Ju lutemi zgjidhni një opsion
6. Cili është numri mesatar i të punësuarve në biznesin tuaj?
8. Aksionerët/Partnerët më të mëdhenj (me mbi 50% të aksioneve) të biznesit tuaj janë:
9. Aktiviteti kryesor ekonomik i biznesit tuaj është:
10. A jeni një kompani eksporti?
11. Ku eksportoni kryesisht:
12. A jeni në dijeni të të drejtave dhe detyri-

meve të operatorëve ekonomikë, sipas rolit dhe përgjegjësisë së tyre në zinxhirin e furnizimit për vendosjen e produkteve në treg, që burojnë nga Ligji 10489/2011 "Për Tregtinë dhe Mbikëqyrjen e Tregut të produkteve joushqimore? Produktet" për operatorët ekonomikë në treg?

13. A mendoni të investoni në përputhje me standardet dhe rritjen e cilësisë së produkteve:
14. Sa e rëndësishme e konsideroni respektimin e standardeve të cilësisë në produktet që prodhoni/tregtoni?
15. Cilat janë disa sfida me të cilat përballen NVM-të shqiptare kur përpiqen të prodhojnë/tregtojnë me standarde?
16. A mendoni se informacioni për infrastrukturën e cilësisë së produktit (rregulloret teknike, standardizimi, akreditimi, vlerësimi i konformitetit, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut) është lehtësisht i aksesueshëm?

17. A jeni në dijeni të kërkesave specifike në legjislacionin në fuqi për produktet e prodhuara/tregtuara sipas aktivitetit tuaj ekonomik (lënda e parë/e futur në zinxhirin e krijimit të vlerës)?
18. Nëse nuk keni informacion ose jeni duke kërkuar informacionin më të fundit, ku shkoni fillimisht për informacion:
19. A ka një portal/faqe të veçantë për NVM-të ku mund të gjejnë të gjithë informacionin përkatës për vendosjen e produkteve në tregun e brendshëm, në lidhje me rregulloret ekzistuese/të reja dhe si të respektohen ato kundrejt vlerësimit të konformitetit?
20. A mendoni se një portal i tillë (si më sipër) është i nevojshëm për operatorët ekonomikë në treg?
21. A ka një portal/faqe të dedikuar për NVM-të ku mund të gjenden informacione të përditësuara përkatëse në lidhje me eksportimin në tregun e vetëm të BE-së?
22. A mendoni se një portal i tillë (si më sipër) është i nevojshëm për eksportuesit?
23. A mendoni se duhet të krijohet një pikë e vetme kombëtare kontakti (Helpdesk) për eksportuesit në lidhje me informacionin për harmonizimin me kërkesat e tregut të përbashkët të BE-së:
24. Nëse po, ku mund të vendoset:
25. A e dini nëse ka një institucion të caktuar qeveritar përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm të politikave në infrastrukturën e cilësisë (rregulloret teknike, standardizimi, akreditimi, vlerësimi i konformitetit, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut)?
26. A keni marrë pjesë rregullisht në forume për dialogun ndërmjet organizatave kom-

bëtare të standardeve (OSK) dhe shoqatave të biznesit që përfaqësojnë SME-të lidhur me sfidat ndaj certifikatave të konformitetit (testim, inspektim, certifikim)?

27. Në përpjekjet tuaja, ku keni pasur më shumë sfida në lidhje me besueshmërinë e produktit tuaj:
28. A ju ofrojnë dhomat e tregtisë/shoqatat e biznesit informacion të përditësuar (p.sh. buletinet) mbi detyrimet që lidhen me infrastrukturën e cilësisë, standardet dhe aktivitetet e standardizimit?
29. A keni qenë subjekt i inspektimeve nga organet shtetërore të inspektimit?
30. Keni konstatuar praktika të parregullta nga ana e inspektorateve shtetërore:
31. Praktikrat e parregullta nga inspektoriatet shtetërore kanë qenë kryesisht të lidhura me:
32. Nëse eksportoni, a njihen dokumentet e vlerësimit të konformitetit të lëshuara nga organet kombëtare të vlerësimit të konformitetit?
33. A ofron shteti masë (këshilla, etj.) për të lehtësuar aksesin e NVM-ve për të certifikuar produktet/shërbimet e tyre?
34. Sipas mendimit tuaj, çfarë hapash mund të ndërmarrë qeveria shqiptare për të mbështetur NVM-të në prodhimin dhe tregtimin e produkteve që plotësojnë standardet ndërkombëtare?
35. A ka ndonjë masë financiare shtetërore (p.sh. subvencione) që ulin koston e përvetësimit të standardeve për NVM-të?
36. A i nënshtroheni procedurave të vlerësimit të konformitetit (testime, certifikime, inspektime) në lidhje me plotësimin e kërkesave të detyrueshme tekniko-ligjore, aplikimin e standardeve të harmonizuara

për lëshimin e certifikatave të konformitetit...?

37. A janë akredituar organet përkatëse të vlerësimit të konformitetit?
38. Sa i përket vlerësimit të konformitetit të produktit tuaj, a keni një laborator/pajisje teknologjike për kryerjen e analizave brenda kompanisë suaj?
39. A keni personel të aftë për të kryer analiza brenda kompanisë suaj?
40. A kryeni trajnime të vazhdueshme të stafit në lidhje me zbatimin e standardeve përkatëse të përditësuara?
41. A jeni i certifikuar si kompani kundrejt kërkesave të standardeve ISO?
42. Ju lutemi specifikoni standardin ISO:
43. Rendisni disa nga problemet që ndikojnë në funksionimin e një tregu konkurrues të drejtë në sektorin ku veproni:
44. Në vijim të synimit për të miratuar së shpejti legjislacionin e BE-së në Shqipëri, nëse produkti juaj do t'i nënshtrohej certifikimit

të markës CE, ku do t'i shihnit vështirësitë në kryerjen dhe ruajtjen e këtij certifikimi:

45. Për të arritur kërkesat e standardeve ose rregulloreve të brendshme ose të BE-së sipas nevojës, ju vlerësoni përvetësimin e njohurive dhe konsulencën profesionale:
46. Për të arritur kërkesat e standardeve ose rregulloreve të brendshme ose të BE-së, do të jeni të gatshëm të ndani kostot përkatëse me shtetin:
47. Bazuar në përvojën tuaj, vlerësoni ndërveprimin me laboratorët e akredituar në vend në lidhje me besueshmërinë e rezultateve:
48. Sipas jush, në përgjithësi, cilat janë 3 barrierat kryesore jotarifore në tregun rajonal?
49. Sipas mendimit tuaj, në përgjithësi, cilat janë 3 barrierat kryesore jotarifore në tregun e përbashkët europian?
50. Komentet e tjera për të shtuar:

SHTOJCA II – PYETËSOR SPECIFIK PËR MAKINERIA/PAJISJET ELEKTRIKE

1. Rendisni produktet që prodhoni/tregtoni:

- a)
- b)

2. A është produkti juaj në objektin e VKM 1060/2015 “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për makineritë’” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara?

3. A është produkti juaj nën objektin e VKM nr. 349/2020 “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”?

4. Nëse JO, ju lutemi specifikoni legjislacionin specifik që është i zbatueshëm për produktet tuaja:

5. Listoni produktet që i nënshtrohen markimit CE të konformitetit

6. A është përfshirë ndonjë organ i njoftuar në vlerësimin e konformitetit për ndonjë nga produktet tuaja?
Nëse PO, ju lutemi specifikoni produktin dhe organin e njoftuar:

7. Ju prodhoni / tregtoni:

a) Vetëm për tregun e brendshëm & b) për tregun europian ☐

c) Për tregjet e Ballkanit Perëndimor v ç) tregjet e vendeve të tjera ☐
d) tregjet e vendeve të tjera ☐

8. Nëse nuk prodhoni/tregtoni në tregun europian, cilat janë disa nga arsyet:

- ☐ Mungesa e njohjes së kërkesave të BE-së për produktin në fjalë
 - ☐ Mungesa e kapaciteteve njerëzore
 - ☐ Mungesa e teknologjisë dhe pajisjeve
 - ☐ Mosnjohja e certifikatave të vlerësimit të konformitetit
 - ☐ Barriera tarifore:
- Nëse PO, ju lutemi specifikoni:
- ☐ Barrierat jotarifore:
- Nëse PO, ju lutemi specifikoni:
- ☐ Të tjera:
 - ☐ Nuk e di

9. A mendoni se operoni në një treg kombëtar të drejtë dhe konkurrues?

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk e di

Nëse JO, ju lutemi specifikoni:

10. Çfarë masash mund të ndërmerren nga organet shtetërore për të reduktuar produktet që nuk përmbushin kërkesat e detyrueshme dhe/ose standardet e harmonizuara për të siguruar konkurrencë të ndershme në treg?

SHTOJCA III – PYETËSOR SPECIFIK PËR PRODUKTET NDËRTIMORE

1. Rendisni produktet që prodhoni/tregtoni:

Sistemi 1+ ☐

Sistemi 1 ☐

2. A jeni në dijeni të kërkesave të Rregullores së BE-së nr. 305/2011 Për produktet e ndërtimit:

Sistemi 2+ ☐

Sistemi 3 ☐

3. A shoqërohet produkti që prodhoni me një Deklaratë Performance?

Sistemi 3 ☐

Nuk e di ☐

4. A është produkti juaj i prodhuar në përputhje me një standard të harmonizuar evropian?

8. A është përfshirë ndonjë organ i njoftuar në vlerësimin e konformitetit për ndonjë nga produktet tuaja?

5. Përcaktoni shenjën e konformitetit të produktit

CE ☐

Jo shenjë ☐

9. Nëse PO, ju lutemi specifikoni organin e njoftuar:

☐ Organi i njoftuar i certifikimit të produktit

☐ organi certifikues i njoftuar i kontrollit të prodhimit

☐ Laborator testimi i njoftuar

6. Listoni produktet që i nënshtrohen markimit CE të konformitetit

7. Sistemi ose sistemet e vlerësimit dhe verifikimit të konsistencës së performancës (AVCP) të produktit të ndërtimit

10. Ju prodhoni/tregtoni:

a) Vetëm për tregun e brendshëm ☐

b) për tregun evropian ☐

c) Për tregjet e Ballkanit Perëndimor ☐

ç) tregjet e vendeve të tjera ☐

d) tregjet e vendeve të tjera ☐

11. Nëse nuk prodhoni/tregtoni në tregun evropian, cilat janë disa nga arsyet:

☐ Mungesa e njohjes së kërkesave të BE-së për produktin në fjalë

☐ Mungesa e kapaciteteve njerëzore

☐ Mungesa e teknologjisë dhe pajisjeve

☐ Mosnjohja e certifikatave të vlerësimit të konformitetit

☐ Mosnjohja e deklaratës së performancës

☐ Të tjera

Barriera tarifore:

Nëse PO, ju lutemi specifikoni:

☐ Barrierat jotarifore:

Nëse PO, ju lutemi specifikoni:

☐ Të tjera:

☐ Nuk e di

12. A mendoni se operoni në një treg kombëtar të drejtë dhe konkurrues?

Nëse JO, ju lutemi specifikoni disa nga arsyet:

13. Çfarë masash mund të ndërmerren nga organet shtetërore për përmirësimin e cilësisë së produkteve të ndërtimit dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat dhe standardet evropiane?

SHTOJCA IV - Indeksi i Politikave të NVM-ve, Ballkani Lindor dhe Turqia 2022

Table 13.20. Albania’s scores for Dimension 7: Standards and technical regulations

Dimension	Sub-dimension	Thematic block	Albania	WBT average
Dimension 7: Standards and technical regulations	Sub-dimension 7.1: Overall co-ordination and general measures		3.89	3.90
	Sub-dimension 7.2: Harmonisation with the EU <i>acquis</i>	Technical regulations	4.64	4.38
		Standards	3.40	3.77
		Accreditation	4.33	3.89
		Conformity assessment	4.24	4.22
		Metrology	5.00	4.13
		Market surveillance	3.40	3.96
		Weighted average	4.17	4.06
	Sub-dimension 7.3: SME access to standardisation	Awareness-raising and information	4.07	3.88
		SME participation in developing standards	3.00	3.21
		Financial support to SMEs	3.40	3.57
		Weighted average	3.49	3.55
Albania's overall score for Dimension 7			4.02	3.96

Note: WBT: Western Balkans and Turkey.

RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomike
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjëse për përmbajtjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council

